

Titulli i lëndës: Letërsia e krahasuar

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	<i>Letërsia e krahasuar</i>
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Obligaive
Viti i studimeve:	Viti i V-të, semestri i 10-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Naser Mrasori
Të dhënat kontaktuese:	Naser.Mrasori@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda “Letërsi e krahasuar” si fushë e re studimi, është një domosdoshmëri e kohës, e cila ka shërbyer dhe shërben si urë ndërlidhëse mes letërsive dhe kulturave të ndryshme, dhe sot shumë shpesh quhet edhe si shkencë e analogjive dhe ndikimeve ndërletrare. Letërsia e krahasuar është disiplinë shkencore e cila studion marrëdhëniet dukuritë letrare gjatë raporteve të ndërsjella por edhe me fenomenet joletrare.</p> <p>Emri rrjedh nga latinishtja: <i>comparare</i> që to të thotë <i>krahasoj</i>.</p> <p>Kjo lëndë ka për synim analizën dhe përshkrimin në nivelin universitar, të shumë çështjeve bazë të letërsisë së krahasuar, si qëllim të studimit të letërsisë. gjatë studimit, krahasimit dhe analizave, do të jepen karakteristikat specifike të kësaj fushe. Nepëmjet shembujve konkret, të krijimtarive që u takojnë gjuhëve dhe kulturave të ndryshme, atyre që i përkasin të njëjtës trevë gjuhësore dhe kulturore, paraqiten teoritikisht dhe praktikisht gjatë zhvillimit të kësaj lënde. Në pjesën përfundimare të lëndës trajtohen çështjet themelore të një poetike krahasuese, teoritë e ndryshme, receptimi, hermeneutika, interkulturaliteti, etj.</p>

Qëllimet e lëndës:

Lënda “Letërisi e krahasuar” synon që studenti:

- të njihet në përgjithësi me o objektin e studimit të letërsisë së krahasuar, letërsinë kombetare dhe atë botërore;
- me studimin e çdo objekti të quajtur letrar, duk e vënë në marrëdhënie me elementët e tjerë përbërës të një kulture.
- të njihet me konceptet dhe me metodologjitë e letërsisë së krahasuar
- me definicionet e letërsisë së krahasuar;
- me nocionet e përgjithshme të letërsisë së krahasuar;
- shkollat e letërsisë se krahasuar si psh. Franceze, amerikane , gjermane, etj.
- të njihet me artin metodik nëpërmjet kërkimit të lidhjeve analogjike, të afrisë dhe te ndikimit;
- me ndikimet ndërletrare
- me zhvillimin e temave dhe formave të letërsisë së krahasuar;
- me dallimin dhe perkufizimin e letërsisë krahasuese;
- me zgjedhjen e veprave letrare - krahasuese;
- me fushat semantike dhe konotacionet e termave;
- me historinë dhe zhvillimin e saj në periudha të ndryeshme kohore;
- me teoritë e përkthimit dhe stilistikën e krahasuar dhe
- shkollat dhe metodat e letërsisë

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas mbarimit të kursit, studenti duhet të ketë njohuri të mjaftueshme:

- për objektin e studimit të letërsisë krahasuese;
- për metodologjitë e studimit të letërsisë së krahasuar;
- për rolin dhe rendësinë e letërsisë krahasuese;
- për ndikimet ndërletrare;
- për detyrat dhe qëllimet e studimit të letërsisë së krahasuar;
- për rolin dhe kontributin e përkthimit në zhvillimin e letërsisë së krahasuar;
- të jenë në gjendje të dallojnë dhe të shpjegojnë raste konkrete të ndikimeve, analogjive, përafrive në letërsinë origjinale dhe në atë të përkthyer.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokviume / Seminare	7	4	28

Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanak(bibliotekë, shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (test, provim)	2	2	4
Projekte, prezantime	30	1	0.5
Seminare, kollokviume	1	1	10
Total			162.5:25 = 6.5 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Lexohen dhe analizohen vepra që kanë shembuj konkret të ndikimeve, ngjajshmerive,analogjive në letërsi .Në fillim të ligjeratës gjithmonë zhvillohet debat për leksionin paraprak.Në vazhdim me temat e radhës dhe në fund të ligjeratës bëhet një përsëritje e përbashkët e leksionit të posa zhvilluar.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi është paraparë të bëhet mbështetur në statutin e Universitetit të Prishtinës (provimi me shkrim dhe me gojë), dhe duke pasur parasyshë edhe punën dhe angazhimin e studentëve gjatë vitit akademik si psh. Pjesëmarrja, anazhimi, punimet seminarike, testet, referimet, diskutimet etj.
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - AngelikaCOBINEAU: Einfuehrung in die Komparatistik.2 ueberarbeite und erweiterte Auflage. - Erich Schmidt,Berlinn 2004,ISBN 3-503-07909-2 - Ernst Grabowzski: Vergleichende Literaturwissenschaft fuer Einsteiger.Boehlau/UTB,Wien/Stuttgart 2011,ISBN 978-3-8252-3565-9. - Manfred Schmeling(Hrsg):Vergleichende Literaturwissenschaft.Theori und Praxis.Athenaion,Wiesbaden 1981,ISBN 3-7997-0764-6 - Yves Chevrel: Letërsia e krahasuar. Albin, Tirane 2002. - Umberto Eco, <i>Për letërsinë</i>, Tiranë, 2007 - Rene Velek, Ostin Voren, Teoria e letërsisë, Prishtinë, 198 - Ernst Grabowzski: Vergleichende Li.wissenschaft für Einsteiger. - Evi Zemanek, Alexander Nebrig (Hg.)Komparatistik.Akademie Verlag, Berlin, 2012, - H.Brackert, J.Stückrath. Literaturwissenschaft. 2001. - Rüdiger Zymner und Achim Hölter. Handbuch Komparatistik. Theorien, Arbeitsfelder, Wissenspraxis. 2013 Springer-Verlag GmbH Deutschland

Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Jordan, L./Kortländer, B. (Hgg.) 1995: Nationale Grenzen und internationaler Austausch. Studien zum Kultur- und Wissenschaftstransfer in Europa. Narr, Tübingen, 1995. - Naser Mrasori. Kur Stefan Cvajg na flet shqip. Rozafa, Prishtinë, 2008. - Naim Kryeziu. Hajnrih Hajne poet i lirisë dhe i dashurisë. Rozafa, Prishtin, 2012. - M. de Matteis, B. Kadzadej, J. Röhling, (Hg). nterkulturalität und Landeswissenschaft. Athena, 2010, Oberhausen. - Osman Gashi, Studime interliterare, Prishtinë, 2001
--------------------	--

Hartimi i planit mësimor

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë</i>	<p>Përkufizimet e letërsisë së krahasuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Letërsia e përgjithshme - Letërsia kombëtare - Letërsia botërore - Letërsia si shkencë - Letërsia e krahasuar etj.
<i>Java e dytë</i>	<p>Hyrje në letërsinë e krahasuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zanafilla dhe zhvillimi i letërsisë së krahasuar - Roli dhe rëndësia e saj - Metodrat dhe fushat e studimit
<i>Java e tretë</i>	<p>Shkenca e përkthimit dhe teoritë e përkthimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkthimi letrar apo rikrijimi - Problemet e kalimit nga një gjuhë në një tjetër - Teoritë moderne
<i>Java e katërt</i>	<p>Përkthimi letrar në letërsinë e krahasuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Roli dhe rëndësia e përkthimit dhe përkthyesve në lindjen dhe zhvillimin e letërsisë së krahasuar - Përkthyesi si ndërmjetës - Përkthimi si bartës i vlerave kulturore - Përkthimi i letërsisë gjermane në shqip
<i>Java e pestë</i>	<p>Letërsia kombëtare dhe letërsia e huaj</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhjet mes letërsive - Ndikimet e autoreve të mëdhenj në letërsitë e ndryshme botërore - Ndikim, analogji apo ngjashmëri - Ndikimi i veprave letrare në shoqëri.

<i>Java e gjashtë</i>	Shkëmbimet dhe ndikimet nga letërsitë huaja në letërsinë kombëtare <ul style="list-style-type: none"> - ndikimet gjuhësore - ndikimet kulturore, historike dhe ideologjike
<i>Java e shtatë</i>	Miti në letërsi; <ul style="list-style-type: none"> - Receptimi i miteve - Miti dhe mitologjia - Mitologjia e krahasuar, studimet mbi mitet letrare
<i>Java e tetë</i>	Sistemi i pritjes: <ul style="list-style-type: none"> - Hermeneutika - Jehona e veprës së përkthyer - vlerësimet kritiko-letrare
<i>Java e nëntë</i>	Receptimi: <ul style="list-style-type: none"> - Historia e receptimit - Estetika e receptimit - Mënyra e përhapjes i veprës së përkthyer letrare - Lexuesit dhe pranimi nga ana e lexuesit
<i>Java e dhjetë</i>	Receptimi letrar: <ul style="list-style-type: none"> - Ndikimi, jehona, përhapja - Mënyra e bartjes dhe ndërmjetësimi
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Letërsia shumë-gjuhësore: <ul style="list-style-type: none"> - Letërsia në vendet shumëgjuhësore dhe ato me migracion të madh - Ndikimet moderne dhe llojet e ndikimit - Shumëllojshmëria e ndikimit
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Intermedialiteti (Letërsi/Film,Letërsi/Fotografi, Letërsi/Muzikë, Letërsi/Media etj. - Interkulturaliteti (kontaktet kulturore,dialogu ndërkulturor, filozofia, religjioni, shoqëria,politika etj)
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Epokat, rrymat, lëvizjet dhe grupet letrare: <ul style="list-style-type: none"> - Realizimi i rrymave letrare - Marrëdhëniet e rrymave - Themelet e shqyrtimit metodologjik dhe kritik të tyre
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Krahasimi në letërsi <ul style="list-style-type: none"> - Krahasimi si shkencë - Krahasimi si metodë - Metodatat dhe tipet e krahasimit

Java e pesëmbëdhjetë

Shkollat dhe metodat e studimit të letërsisë

- shkolla franceze - strukturalizmi dhe post-strukturalizmi
- shkolla amerikane - te amerikanët dominoi Kritika e Re
- shkolla gjermane - te gjermanët ishte dominuese metoda e vëzhgimit të letërsisë si sferë e zhvillimit të shpirtit njerëzor.
- shkolla ruse - te rusët dominoi formalizmi.

- Sipas M. Maren - Erizebah dallon: metodën pozitiviste, fenomenologjike, ekzistencialiste, morfologjike, sociologjike.
- Grupi i autorëve J. Hauf, A. Heler, B. Hipauf, L. Ken dhe K.P. Flipia dallojnë: metodën pozitiviste, formaliste-strukturaliste, hermeneutike dhe marksiste.
- M. Korti dhe Ç. Segre numërojnë tetë metoda: sociologjike, simboliste, psikanalitike, stilistike, historike dhe stilistiko kritike, formaliste, strukturaliste dhe semiologjike.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Përmes këtij kursi studentët thellojnë dijet në këtë fushë duke qenë aktiv në pjesëmarrje, të angazhuar gjatë ligjëratave dhe në punët seminarike. Vijueshmëria e rregullt u ndihmon që ata të kenë më shumë të dhëna në përkufizimet e kësaj fushe, fenomenet e letërsisë së krahasuar, ndikimet dhe komunikimet ndërkulturore, përkthimet letrare, receptimi dhe përhapja e veprës së përkthyer, prandaj ata duhet të vijnë me kohë dhe të motivuar dhe të përgatitur në auditor, mosardhja e rregullt dhe me kohë, sjell ndërprerjen e mësimnxënies dhe i shkakton ndërprerje të marrjes së informacioneve të duhura për pergaditjen e lëndës letërsi e krahasuar.

10.10.2024 MrN